



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Tiranë më 04/08/2020

V E N D I M

Nr. 47, Datë 04/08/2020

Në zbatim të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 786, datë 09.11.2016 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike", Statutit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, si dhe në mbështetje të Rregullores nr. 1, datë 26.07.2017 "Për mbledhjen e të ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike", ndryshuar, Bordi i Mbikëqyrjes Publike sipas rendit të ditës së njoftuar paraprakisht:

V E N D O S I:

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike lëshon vërtetime sipas kërkesës brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e pagesës së tarifës prej 2,500 (dymijë e pesëqind) lekë në llogarinë bankare të BMP-së.
2. Të gjithë subjektet, Auditues Ligjor dhe/ose Shoqëri Auditimi, të cilët kërkojnë pajisjen me vërtetim nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, do të pajisen me vërtetim, pasi të kenë shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj Bordit të Mbikëqyrjes Publike, si dhe/ose çdo detyrim tjetër si rezultat i një mase disiplinore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar  
**Dritan FINO**

Anëtar  
**Adriana BERBERI**

*(Adriana Berberi)*

Anëtar  
**Luan ABAZI**

*(Luan Abazi)*



Anëtar  
**Edlira LUÇI**

( )

Anëtar  
**Klement MERSINI**

*(Klement Mersini)*